



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2019:264259

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05862653

Ac.nr.10848/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.Sh. nga P.....të cilin e përfaqëson e autorizuar Gentiana Behluli nga Prishtina, kundër të paditurit K.P. nga K....., rr.....të cilin e përfaqëson Veton Puka me autorizim, baza juridike pasurim i pabazë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.544/14, i datës 15.10.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 24.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET e themeltë ankesa e të autorizuarit të paditurit K.P. nga K....., rr....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.544/14, i datës 15.10.2021, PRISHET dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.544/14, i datës 15.10.2021, ka vendosur si në vijim: **DETYROHET** i padituri K.P. nga K.....që paditësit L.Sh. ë emër të pasurimit të pabazë i'a paguajë shumën prej 62.278,00 € (gjashtëdhjetë e dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit me kamatë ligjore nga data (15.10.2021), e deri në pagesën definitive , e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë si të pabazuar, në bazë të thënieve ankimore këtë aktgjykim ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje ose padinë ta refuzoj si të pathemeltë.

I autorizuari i paditësit me përgjigjeje në ankesë ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet në tersi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, L.Sh. nga P.....përmes, me datë 27.06.2013 në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi me bazë juridike pasurim i pabazë, kundër të paditurit K.P. nga K....., ku me parashtrësën për precizim e kërkesëpadisë ka kërkuar që aprovohet padia dhe kërkesëpadia si e bazuar, të obligohet i padituri që paditësit t'ia kthej shumen e përgjithshme prej 62.278.59 euro si dhe kamatën ligjore nga momenti ku ka lindur kjo e drejt për mjetet e deponuara në bankat komerciale pa destinim deri me 19.12.2012 dhe pas kësaj date kthimin e kamatës ligjore prej 8%.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkresat e lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.544/14 i datës 15.10.20, me të cilin e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: Nga provat e administruara u vërtetua kjo gjendje faktike se nuk është kontestues fakti në mes të palëve ndërgjyqëse se të paditurit K.P. me datën 22.09.2005 nga Kompania e Sigurimeve Kosova i është transferuar shuma prej 62.278.00 euro në emër të zhdëmtimi për L.Sh.gjë që vërtetohet edhe nga transaksioni i ProCredit Bank i datës 18.12.2020. Nuk është kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse se nga Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me numër P.nr.3/12 të datës 19.10.2012 është vërtetuar se i padituri K.P. është shpallur fajtor ndër të tjerat edhe për veprat penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimit gjyqësor, shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit, pastrim parash dhe për mashtrim për të cila është dënuar me dënim me burgim, ndërsa palët e dëmtuar Kompania e Sigurimeve "Kosova" etj, janë udhëzuar që për realizimin e interesit të tyre pasurore juridike të iniciojnë procedurë kontestimore me anë të padisë. Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës P.ml.nr.26/2018 të datës 15.05.2018 është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Krimeve të Rënda ndërsa pjesërisht është anuluar Aktgjykimi i shkallës së parë vetëm sa i përket veprës penale pastrim i parash. Nga transaksioni i ProCreditBankë të datës 18.12.2020 është vërtetuar që Kompania e Sigurimeve "Kosova" në emër të zhdëmtimit për këtu të paditësin L.Sh. e xhirollogarinë e këtu të paditurit K.P. është transferuar shuma prej 62278 euro me datën 22.09.2005. Nga kjo gjendje faktike në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i padituri K.P. është pasuruar në mënyrë të pabazë në dëm të paditësit L.Sh. ë shumën prej 62278 euro, e duke pranuar këtë shumën si kompensim për aksidentin e pësuar përkatësisht lëndimet e pësuar nga paditësi si pasojë e aksidentit të vitit 1996, me qka paditësit i ka shkaktuar dëm në shumën prej 62278 euro. Sipas nenit 194 par.1 të LMD-së përcaktohet se "Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur".

Tutje gjykata ka shtuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me pasurim të pabazë të të paditurit K.P. sepse në këtë rast kemi të bëjmë me rritje të aktivitetit të tij në shumën prej 62278 euro, pasurimi është shkaktuar në kurriz të huaj në këtë rast të paditësit L.Sh., pasurimi është pa bazë juridike për shkak se i njëjti nuk ka pas autorizimi nga këtu paditësi L.Sh. që të pranojë të hollat nga Kompania e Sigurimeve "Kosova" në emër të lëndimeve të pësuar nga këtu paditësi L.Sh. si pasojë e aksidentit, për qka edhe është dënuar për vepër penale. Sipas dispozitave të nenit 14 të LPK-së "gjykata në procedurën kontestimore në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor e në këtë rast këtu i padituri Kole Puka është shpallur fajtor për disa vepra penale e në mesin e tyre nxjerrje e vendimit të kundërligjshëm dhe mashtrim.

Gjykata vendosi që secila nga palët të i bartë shpenzimet e veta të procedurës duke marrë parasysh dispozitat e nenit 463 par 1 të LPK-së "që për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendos vetëm me kërkesën e specifikuar të palës pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht

lidhur me kërkesën ‘’, mirëpo pasiqë pala paditëse dhe e autorizuar e tij nuk kanë paraqitur kërkesën e specifikuar të shpenzimeve procedurale gjykata vendosi që secila nga palët të i bartë shpenzimet e veta të procedurës. Vendimi mbi kamatën është i bazuar në dispozitat e nenit 378 i LMD-së.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në aktgjykimin e atakuar, gjykata ju ka referuar nenit nenit 194 paragraf 1 të LMD-së.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin e atakuar dhe duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), nenit 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, e për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar një dispozite materiale juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadisë.

Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje nga neni 183 i LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se:

Për të ekzistuar pasurimi pabazë duhet të plotësohen të gjitha kushtet që kërkojnë në bazë të nenit 210, 211, 212, dhe 213 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të datës 01 tetor 1978, i cili ka qenë në fuqi në kohen kur pretendohet se ka ndodhur pasurimi i pa bazë. Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore del përfundimi se për të ekzistuar pasurimi pabazë duhet të plotësohen katër kushte: a) që të ekzistoj pasurimi i cili mund të shprehet në rritjet të aktivitetit dhe zvogëlim të pasivitetit, b) që pasurimi të jetë shkaktuar në kurriz - dëm të personit tjetër që mund të jetë i shprehur me kalimin e një pjese të pasurisë nga një person në personin tjetër, më pagesën e shumës e të hollave, në dorëzimin e ndonjë sendi apo më kryerjen e ndonjë veprimi, c) që të ekzistoj lidhja shkakore në mes të pasurimit dhe varfërimit dhe d) pasurimi duhet të jetë bërë pa bazë juridike apo në fillim gjegjësisht në krijimin e raportit të detyrimeve baza juridike ka ekzistuar mirëpo me kalimin e kohës ajo bazë ka dështuar. Duke marrë për bazë këto rrethana - këto kushte të domosdoshme, që të ekzistoj pasurimi pa bazë, rrjedh se elementet të cilat karakterizojnë pasurimin pa bazë janë: zmadhimi apo rritja e pasurisë në njërin anë, zvogëlimi i pasurisë në anën tjetër, lidhja shkakore në mes të zmadhimit dhe zvogëlimit të pasurisë dhe mos ekzistimi i bazës juridike.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar ka detyruar të paditurin që paditësit t'ia paguaj në emër të pasurimit të pabazë shumën prej 62.278,00 €, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, mirëpo nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se ka pasur një padi për kompensim demi për aksidentin e dt.21.07.1996 në Gjykatën Komunale në Klinë, ku në këtë padi evidentohet si paditës L.Sh.e të cilin e përfaqëson Mikelj Pepaj avokat nga Gjakova, e po ashtu në shkresa të lëndës është edhe procesverbali i dt.20.07.1998 mbi shqyrtimin kryesor P.nr.311/97 ku ka filluar të shqyrtohet padia e këtij paditësi si dhe në këtë procesverbal është caktuar seanca e radhës me dt.28.07.1997, mirëpo nga shkresat e lëndës nuk ka prova se a ka përfunduar në tersi kjo lëndë, a ka pasur aktgjykim apo eventualisht është përfunduar në mënyrë tjetër kjo çështje juridike. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë në shikim të gjitha shkresat nga lënda P.nr. 311/97, krejt kjo me qëllim të vërtetimit të fakteve se deri në cilën fazë ka shkuar procesi gjyqësor në lëndën e lartcekur ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të paditurit gjatë shqyrtimit kryesor dhe pretendimeve ankimore. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë, para se të vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar është dashur të vërtetojë faktin se a është filluar në vitin 1997 procedura për kompensimin e demit nga ana e paditësit, nëse po në cilën fazë ka arritur, dhe se a janë marrë provat nga lënda P.nr.311/97 nga tani i padituri me qëllim të arritjes së Ujdis Jashtëgjyqësore të datës 28.02.2005, dhe si rezultat i kësaj, ka bërë shkelje dispozitave të lartcekura të LPK-së

Si shkak i vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për të cilën gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare, me çka mbi bazën e shkeljeve të konstatuara aktgjykimi i atakuar u dashtë që të prishet dhe të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, pastaj gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nëpërmes dëgjimit të palëve ndërgjyqëse e në rast nevojë edhe ballafaqimi i tyre, të marrë në shikim shkresat e lëndës P.nr.311/97, në rast nevojë të bëjë dëgjimin e dëshmitarëve dhe provave të propozuara nga palët, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika c) e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10848/2021, me datë 24.06.2024

Kryetari i kolegjit

Naim Mehulli, d.v